



Prishtinë: 12.11.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1313_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: ZRRE/DMK_V_2086_09_20;
- Ankesa e konsumatorit e datës 27.10.2020.

në seancën e mbajtur më datë 12.11.2020, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET ankesa e konsumatorit Fatmir Idrizi, nga Komuna e Fushë Kosovës me shifër të konsumatorit DPR – 90110759 si e pa bazuar, ndaj vendimit të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE.
- II MBETET në fuqi vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_2086_09_20 i datës 09.09.2020.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 27.10.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori Fatmir Idrizi, nga Komuna e Fushë Kosovës, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: vendimi i DMK në ZRRE nuk ka marrë për bazë nenin 360, par. 1 pika 1.1 të Ligjit për Marrëdhënie Detyimore Nr.04/L-077, ku sipas këtij neni kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti janë kërkesat për furnizim me energji elektrike, energji termike, gazit, ujit dhe shërbimeve të pastrimit, të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimeve të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevoja shtëpiake. Pra në ankesë konsumatori ka theksuar se kërkon nga Bordi i ZRRE që kontesti të zgjidhet sipas nenit 360 dhe pikave 1 dhe 2 të nenit 341 të Ligjit për Marrëdhënie Detyimore.

Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se kërkon nga Bordi i ZRRE-së që pezulloj vendimin e DMK-së me nr ZRRE/DMK_V_2086_09_20 të datës 09.09.2020.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 12.11.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE gjatë analizës së bërë ankesës së konsumatorit kundër vendimit të organit të shkallës së parë të ZRRE (Vendimi i DMK në ZRRE), ka vërejtur se ankesa nuk përmban asnjë argument lidhur me



çështjen meritorë, e që ndërlidhet me ngarkesën shtesë, respektivisht me korigjimin nr. 93948DPR-90110759 të datës 20.02.2019, pra konsumatori nuk ka dhënë asnjë argument se pse ky korigjim shtesë nuk është i saktë, por ankesën e ka bazuar vetëm në Ligjin për Marrëdhënie Detyrimore, pra kinse borxhi është parashkuar.

Bordi i ZRRE thekson se nuk mund të kontestohet fakti që në procesverbalin e pranimit të njehsorit elektrik nr.0088938 të datës 27.01.2016 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 39071121 me gjendje TL=005025 kWh dhe TU=002934 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr.39698187 me gjendje TL=000276 kWh dhe TU=000162 kWh, si dhe poashtu kanë evidentuar që njehsori elektrik nr.39071121 ka klemen e zeros të djegur, andaj edhe duhet të dërgohet në qendrën e kalibrimit për shqyrtim, si dhe të faturohen shërbimet për lidhje të re. Pra shihet qartë se në këtë procesverbal është evidentuar nga punëtorët e KEDS që te konsumatori në fjalë ka ekzistuar njehsori nr. 39071121 me gjendje TL=005025 kWh dhe TU=002934 kWh.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka vërejtur se bazuar në analizën e procesverbalit nr.0088938 të datës 27.01.2016 dhe transaksioneve të konsumatorit konstaton se njehsori elektrik nr.39071121 nuk ka qenë i regjistruar në KEDS, rrjedhimisht konsumatori nuk ka pasur shifër të hapur, e që nga dokumentet konstatohet se me datë 26.02.2016 konsumatori është ngarkuar me faturën mbi shërbimet për lidhje të re, në vlerë prej 118€, si dhe i është hapur shifra DPR-90110759. Bordi ka vërejtur se shpenzimi i regjistruar në procesverbalin e lartcekur deri në periudhën 20.02.2019 nuk janë faturuar, e që kjo paraqet një periudhë kohore prej 3 vjetëve.

Bordi i ZRRE konstaton se vendimi i organit të shkallës së parë të ZRRE, me të cilën ka theksuar se bazuar në mesataren e përgjithshme të shpenzimeve (mesatarja e shpenzimit nga periudha 03/2016 deri në periudhën 08/2020 është 406.03 kWh/mujor), shpenzimi i energjisë elektrike i faturuar prej 7,959 kWh do të paraqiste shpenzimin e supozuar prej 20 muajve, dhe se faturimi i këtyre kWh për një muaj nuk mund të paraqet shpenzim real mujor të konsumatorit, është konstatim plotësisht i saktë dhe i drejtë. Pra Bordi i ZRRE konstaton se KESCO dhe KEDS nuk kanë respektuar nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: "1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit".

Bordi i ZRRE konstaton se vendimi i organit të shkallës së parë të ZRRE në të cilën është konstatuar se Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 paragrafin 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: "Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktajnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese", është plotësisht konstatim i saktë dhe i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete. Pra Bordi i ZRRE konstaton se vendimi i organit të shkallës së parë me të cilën ka kërkuar konsumatorit duhet t'i bëhet shpërndarja e kWh të faturuar, bazuar në mesataren e shpenzimeve të përgjithshme për periudhën 20 mujore 06/2014 deri në periudhën 01/2016 dhe se korigjimi duhet të jetë në vlerë 473.12€, si dhe për këtë t'i ofrohet kontratë për pagesë për periudhën 20 mujore është plotësisht e saktë dhe e drejtë.

Bordi i ZRRE-së thekson se sa i përket pretendimit të konsumatorit, se ZRRE duhet të merr për bazë parashkrimin e borxhit sipas nenit 360 të Ligjit për Marrëdhënie Detyrimore, ju informojmë se ZRRE



nuk ka kompetencë ligjore për të konstatuar se a ekziston parashkrime të borxhit të energjisë elektrike, dhe për një konstatim të tillë kompetente janë gjykatat e rregullta.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.11.2020 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Boardi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit Fatmir Idrizi dhe
- Arkivit të ZRRE-së.